



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 196 Akti

Nr. 214 Vendimi  
Tiranë, më 22.11.2019

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Alma Faskaj</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 20 nëntor 2019, ora 12:00 dhe 21 nëntor 2019, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Vrioni, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**

**Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;**

**Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;**

**Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.**

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Vrioni, me funksionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka hedhur shortin në datën 17.9.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Vrioni, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Alma Faskaj. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 3.10.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Vrioni<sup>1</sup>.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Vrioni, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse

---

<sup>1</sup> Vendimi ndërmjetëm nr. 1, datë 3.10.2018.

subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i KLD. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**10. Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI),** ka dërguar një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Vrioni, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK),** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

**12. Inspektorati i KLD-së,** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e

---

<sup>2</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2018.

provueshmërisë dhe në datën 28.10.2019 vendosi<sup>3</sup>: (i) përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Vrioni; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47, të ligjit 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit në datën 29.10.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 30.10.2019.

**16.** Në datën 5.11.2019, për shkak të evidentimit dhe administrimit të provave të reja nga Komisioni, pas mbylljes së hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë – trupi gjykues vendosi riçeljen kryesisht të hetimit administrativ, si dhe njoftoi subjektin lidhur me këtë vendim<sup>4</sup>.

**17.** Në datën 7.11.2019 subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision nëpërmjet postës elektronike – kërkesë për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe njohjen me të gjithë dokumentacionin e grumbulluar nga Komisioni edhe për këto dy kriteret.

**18.** Në datën 8.11.2019, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, vlerësoi se deri në këtë fazë të hetimit provat e grumbulluara kanë arritur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 52, të ligjit 84/2016 dhe vendosi: mospranimin e kërkesës, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit për këtë vendim<sup>5</sup>.

**19.** Po në datën 8.11.2019, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet shtesë të hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilat vlerësoi se arrijnë nivelin e provueshmërisë, vendosi<sup>6</sup>: përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, si dhe i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit, z. Arben Vrioni, rezultatet shtesë të hetimit.

**20.** Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit në datat 10.11.2019 dhe 14.11.2019.

**21.** Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>7</sup>.

---

<sup>3</sup> Vendimi ndërmjetëm nr. 2, datë 28.10.2019.

<sup>4</sup> Vendimi ndërmjetëm nr. 3, datë 5.11.2019.

<sup>5</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 8.11.2019.

<sup>6</sup> Vendimi ndërmjetëm nr. 5, datë 8.11.2019.

<sup>7</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 6, datë 18.11.2019.

## II. SEANCAT DËGJIMORE

**22.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 19.11.2019.

**23.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Arben Vrioni, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 20.11.2019, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish- Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

**24.** Me fillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit depozitoi kërkesë për rihapjen e hetimit administrativ dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe vlerësimin profesional. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi për të vendosur lidhur me këtë kërkesë – pas shqyrtimit të së cilës vendosi mospranimin e saj<sup>8</sup>.

**25.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi për administrimin e kësaj kërkesë. Pasi vlerësoi se kërkesa e depozituar nga subjekti i plotëson kriteret e parashikuara nga ligji – vendosi ta dërgojë për shqyrtim nga një tjetër trup gjykues, i ngritur në Komision.

**25.1** Paraprakisht, në datën 19.11.2019, Komisioni ka marrë vendim<sup>9</sup> për ngritjen e një trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës së mundshme të subjektit të rivlerësimi, z. Arben Vrioni, për përjashtimin e trupit gjykues që rivlerëson çështjen e tij, për shkak të konfliktit të interesit apo si pasojë e thirrjes në seancë dëgjimore bazuar vetëm në një kriter.

**25.2** Pas shqyrtimit të kërkesës së depozituar nga subjekti për përjashtimin e trupit gjykues që rivlerëson çështjen e tij – trupi gjykues i ngritur për shqyrtimin e saj vendosi ta rrëzojë këtë kërkesë<sup>10</sup>. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë vendim.

**26.** Me rifillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit pretendoi se është në kushtet e pamundësisë për të vazhduar seancën dëgjimore për arsye shëndetësore, si edhe kërkoi të ushtroj të drejtën e mbrojtjes me avokat.

**26.1** Trupi gjykues, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi për vlerësimin e kësaj kërkesë – vendosi t’i japi kohë subjektit të rivlerësimit për dorëzimin e dokumentacionit provues mbi gjendjen e tij shëndetësore<sup>11</sup>.

**26.2** Subjekti i rivlerësimit dorëzoi nëpërmjet postës elektronike<sup>12</sup> dokumentacion të skanuar – raport mjekësor dhe fletë-dalje nga Spitali \*\*\*, të cilat përkojnë me periudhën 15 -18 qershor 2019.

**26.3** Pasi shqyrtoi këtë kërkesë të deklaruar në seancë dëgjimore dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave të depozituara – trupi gjykues vendosi të mospranojë kërkesën e subjektit

<sup>8</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 7, datë 20.11.2019.

<sup>9</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 19.11.2019, nr. \*\*\*prot., datë 19.11.2019.

<sup>10</sup> Vendimi nr. \*\*\*prot., datë 20.11.2019.

<sup>11</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 9, datë 20.11.2019

<sup>12</sup> *E-mail* datë 20.11.2019, ora 15:02.

për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe zhvillimin e seancës së radhës në datën 21.11.2019, ora 12:30<sup>13</sup>.

**27.** Në seancën dëgjimore të datës 21.11.2019 u relatuan rezultatet e hetimit kryesisht – subjekti i rivlerësimit, z. Arben Vrioni, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve lidhur me rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Vrioni, kërkoi nga Komisioni riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**28.** Z. Arben Vrioni nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016 – duke bërë kërkesa të vazhdueshme të pabazuara në prova e në ligj, të cilat mund të përbënin shkak për zvarritjen e procesit.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**29.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**29.1** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**29.2** Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**29.3** Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017<sup>14</sup> dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces

<sup>13</sup> Vendim i ndërmjetëm nr.10, datë 20.11.2019.

<sup>14</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**30.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**31.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**31.1** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Vetting, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ, si dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Vrioni.

**31.2** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

➤ Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme).

**32. Pasuria e llojit apartament, me sip. 71 m<sup>2</sup>,** ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*. Sipas raportit të vlerësimit të datës 6.12.2016, vlera e këtij apartamenti është 4,494,300 lekë. Subjekti ka deklaruar se zotëron 41.67% pjesë të kësaj pasurie, ndërsa bashkëshortja e tij zotëron 58.33% të saj.

**32.1** Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është përfituar me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore në vitin 1993 – dhe se është bashkëpronar me bashkëshorten në këtë pasuri pas: (i) *çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerëve G., dhe A.M.,* (prindërit e bashkëshortes) dhe; (ii) *dhurimit të pjesës që trashëguan nga kjo pasuri nga znj. J. Z., dhe znj. E. D.,* (motrat e bashkëshortes), në favorin e tij dhe të bashkëshortes së tij.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**32.2** Referuar deklaratës fillestare të deklarimit të pasurisë (dorëzuar në datën 9.3.2004 në ILDKPKI), konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë, apartament banimi (pa vlerë të

deklaruar), të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Bulevardi “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Elbasan – dhe se zotëron 25% pjesë takuese të kësaj pasurie, të përfituar në bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

**32.3** Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti<sup>15</sup> rezulton se – në datën 8.10.1993 është lidhur kontrata<sup>16</sup> për shitblerjen e kësaj pasurie me Ndërmarrjen Komunale Banesa Elbasan, ku në cilësinë e palës blerëse paraqitet z. G.M.,. Ndër të tjera kjo kontratë parashikon se: *“Ndërmarrja Komunale Banesa Elbasan këtë banesë ia ka shitur blerësit G. M., me pjesëtarë madhorë A., A., M...”*.

**32.4** Neni 9, i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, përcakton se: *“...banesat që do privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Banesa që do përdoret nga disa qiramarrës, kalon në pronësi të çdo qiramarrësi, në bazë të pagesës që ka në kontratën e qirasë. Kur qiramarrësit bien dakord midis tyre, banesa mund të kalojë tërësisht në pronësi të njërit qiramarrës.”*

**32.5** Në dosjen që shoqëron këtë pasuri konstatohet dokumenti, vërtetim i datës 14.09.1993, lëshuar nga Bashkia Elbasan, ku vërtetohet se, z. G.M., banor i lagjes “\*\*\*” bashkëjeton me dhëndrin e tij, z. Arben Vrioni, në pallatin \*\*\*, h. \*\*\*, ap. nr. \*\*\*. Ky vërtetim është lëshuar për efekt privatizimi. Gjithashtu, pjesë e dosjes së kësaj pasurie janë 2 certifikatat e përbërjes familjare të datës 1.12.1992.

**32.6** Në datën 19.9.2016 janë lëshuar dëshmitë e trashëgimisë ligjore<sup>17</sup> të z. G.M., dhe znj. A.M., për pjesën takuese të kësaj pasurie, sipas të cilave pjesa tyre takuese që zotëronin mbi këtë pasuri i kalon trashëgimtarëve, tre vajzave të tyre, znj. M.V., znj. E.D., dhe znj. J.Z.

**32.7** Nga verifikimi i kartelës së kësaj pasurie të administruar në dosjen e ILDKPKI – rezulton se në datën 3.11.2016 është kryer rivlerësimi i kësaj pasurie, në vlerën prej 4,494,300 lekësh.

**32.8** Në datën 19.11.2016 nëpërmjet kontratës së dhurimit<sup>18</sup>, znj. J.Z., dhe znj. E.D., (motrat e bashkëshortes së subjektit), i dhurojnë subjektit dhe bashkëshortes së tij pjesën takuese të kësaj pasurie të përfituar nga trashëgimia ligjore e prindërve të tyre.

Me këto veprimeve juridike rezulton se subjekti i rivlerësimit zotëronte 41.67% pjesë të kësaj pasurie, ndërsa bashkëshortja e tij zotëronte 58.33%.

**32.9** I pyetur nga Komisioni se cila është arsyeja e dhurimit të pjesës takuese që u takonte motrave të bashkëshortes mbi këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *[...]prindërit e bashkëshortes i kërkuan me gjallje motrave të bashkëshortes, që nga ky apartament nuk do të kërkonin pjesë dhe ashtu u bë, pasi dhe ato kishin përfituar nga ligji për privatizimin e banesave shtetërore[...].*

**32.10** Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2017<sup>19</sup>, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është shitur në datën 17.11.2017, në shumën prej 4,493,800 lekësh. Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit konfirmohet se – në datën 20.11.2017 nga llogaria e

<sup>15</sup> Me dorëzimin e deklaratës vetting në ILDKPKI.

<sup>16</sup> Kontrata me nr. \*\*\*, datë 8.10.1993.

<sup>17</sup> Dëshmitë e trashëgimisë ligjore: nr. \*\*\*, nr. \*\*\* rep., të datës 16.9.2016.

<sup>18</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 19.11.2016.

<sup>19</sup> Administruar në dosjen e ILDKPKI.



personit fizik, noteres R.R., është transferuar shuma prej 4,493,800 lekësh me përshkrimin: “Tjetërsim pasurie për M.V., S.A kaluar për shitje pasurie nr. \*\*\* ZK \*\*\* blerës M., dhe L.L.”.

▼ Për sa më sipër nga hetimi i kryer lidhur me këtë pasuri Komisioni konstaton se – deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Elbasan për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklarimit dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

**33. Pasuria e llojit apartament**, me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, kati \*\*\*, apartamenti \*\*\*, blerë në vitin 2002, në vlerën 6,000,000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në bashkëpronësi me bashkëshorten, me pjesë takuese 50 % secili.

**33.1** Si burim krijimi ka deklaruar, të ardhurat e përfituara nga nëna e tij të përfituara nga shitja e pasurive në qytetin e Gjirokastrës, të trashëguara nga prindërit e saj. Subjekti, gjithashtu, sqaron se fillimisht është blerë një apartament në pallatin nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*” dhe më pas ky apartament është shitur me disa pagesa dhe shitja përfundimtare është kryer në vitin 2004.

### Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**33.2** Referuar deklaratës fillestare të deklarimit të pasurisë (dorëzuar në datën 9.3.2004 në ILDKPKI) konstatohet se në rubrikën “pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament 3+1, të blerë nga firma “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën prej 6,000,000 lekësh, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Bulevardi “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Elbasan. Subjekti si burim krijimi ka deklaruar: (1) pjesërisht kursimet e tij; dhe (2) pjesën më të madhe me të ardhurat e përfituara nga shitjet e pasurisë së nënës.

**33.3** Për sa më sipër konstatohen mospërputhje lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “Vetting”, si burim krijimi subjekti ka deklaruar – të ardhurat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e pasurive në qytetin e Gjirokastrës – ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë ka deklaruar: (i) kursimet e tij; dhe (ii) të ardhurat nga shitjet e pasurisë së nënës.

**33.4** I pyetur Komisioni nëse ka pasur kontribut në blerjen e kësaj pasurie dhe, nëse po, kur, sa dhe cili ka qenë burimi i të ardhurave – në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se: [...] kontributi tij për blerjen e kësaj pasurie është në vlerën e 1,000,000 lekëve. Këto lekë ishin të kursyera nga subjekti dhe bashkëshortja e tij nga puna ndër vite [...].

**33.5** ZVRPP-ja Elbasan<sup>20</sup>, konfirmon se në emrin subjektit në bashkëpronësi me bashkëshorten – figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 157 m<sup>2</sup>.

**33.6** Nga verifikimi i dosjes së kësaj pasurie, ndër të tjera konstatohet se: (i) në prill të vitit 2004 kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit I.L.T., dhe në datën 16.1.2007 është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të tij; (ii) në datën 1.9.2015 është regjistruar kjo pasuri në emrin e subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe se, po në të njëjtën datë është lëshuar certifikata e pasurisë në emrin e tij.

<sup>20</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 802.2019.

**33.7** Referuar kontratës së shitblerjes<sup>21</sup> së kësaj pasurie të datës 31.8.2015 konstatohet se shtetasit I., dhe E.T., i kanë shitur pasurinë e llojit apartament me sip. 157 m<sup>2</sup> të ndodhur në z.k. \*\*\*, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë: lagjja “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\* ap. \*\*\*, për çmimin 6,000,000 lekë, i cili është likuiduar dhe pasqyruar sipas mandateve: nr. \*\*\*, datë 3.7.2002, në shumën 4,000,000 lekë; nr. \*\*\*, datë 2.2.2003, në shumën 1,400,000 lekë dhe; nr. \*\*\*, datë 10.7.2003, shuma 600,000 lekë<sup>22</sup>.

**33.8** Për sa më sipër konstatohet se megjithëse subjekti ka deklaruar këtë pasuri që në deklaratën fillestare (dorëzuar në ILDKPKI, në datën 9.3.2004), dhe se po ashtu në deklaratën “Vetting” se është blerën në vitin 2002, kontrata e shitjes së kësaj pasurie është bërë në vitin 2015.

**33.9** Komisioni, lidhur me faktin e mësipërm ka pyetur subjektin, duke i kërkuar të shpjegojë se mbi çfarë marrëdhënie juridike është bazuar për të deklaruar pronësinë e kësaj pasurie në deklaratën fillestare të pasurisë dhe subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se: [...] në vitin 2002 keni lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe se që në shtator të këtij viti ka filluar të banjë tek ky apartament [...].

**33.10** Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kontratë sipërmarrje me firmën “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila nuk ka datë të plotësuar. Vërehet se si datë të lidhjes së kontratës ka referuar datën e shënuar në mandatpagesën e kështit të parë në datën 3.7.2002.

**33.11** Në vijim subjekti ka sqaruar se edhe pse familja e tij filloi të banojë në këtë apartament në shtator të vitit 2002, kjo pasuri është hipotekuar nga subjekti ndërtues vetëm në vitin 2015, kur ai dhe banoret e tjerë të pallatit u pajisën dhe me certifikatën e pronësisë, pasi marrja e lejes së shfrytëzimit nga Zyra e Urbanistikës u zgjat në kohë, për shkak të panjohura për ta. Ky është shkaku që kontrata e blerjes daton në vitin 2015 [...].

↓ **Për sa më sipër, Komisioni, konstaton se:** (i) deklarimi subjektiv gjatë procesit të hetimit administrativ nuk është në harmoni me provat e administruara nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, pasi është e konfirmuar se kjo pasuri është regjistruar që në vitin 2004 në emër të shtetasit I.L.T.; (ii) subjekti pretendon se ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. – por ndërkohë kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie është lidhur me z. I.T., si individ – dhe jo në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**33.12** Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuar të japë shpjegimet e tij lidhur me mospërputhjet e konstatuara. Subjekti dërgoi prapësimet<sup>23</sup> e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektivit nuk janë bindëse dhe nuk arritën të provojnë të kundërtën e këtij konstatimi.

**33.13** Me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, për të dokumentuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka depozituar depozituar dokumentet: kontratë shitblerje prone nr. \*\*\*, datë 13.11.1996; kontratë kapari nr. \*\*\*, datë

<sup>21</sup> Kontrata nr. \*\*\*, datë 31.8.2015.

<sup>22</sup> Referohuni, nenit 3 të kontratës së shitjes së kësaj pasurie.

<sup>23</sup> Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 10.11.2019.

27.11.1999; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 17.7.2000; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 5.3.2004; dhe kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 13.11.1996.

**33.14** Referuar dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 13.11.1996 nëna subjektit, znj. H.V., në cilësinë e bashkëpronares, ka shitur pasurinë e llojit shtëpi banimi 3-katëshe dhe truallin rreth saj, në vlerën prej 400,000 USD. Pjesa takuese e saj – përlllogaritur në shumën 57,143 USD.

**33.15** Në datën 27.11.1999, nëna e subjektit ka lidhur kontratën e kaparit me shtetasin I. H., për shitblerjen e pasurisë të llojit shtëpi banimi të përbërë nga tre dhoma dhe një kuzhinë, në truallin e saj përkatës, që ndodhet në pallatin \*\*\*, ap. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, sipas së cilës është dhënë kapari prej 1,500,000 lekësh për të garantuar shitblerjen e pasurisë së kaparpranuesit – në total vlera e përcaktuar e shitjes – shuma prej 4,500,000 lekësh. Referuar kontratës së kaparit, të dyja palët (shitësi kaparmarrës dhe blerësja kapardhënëse), deklarojnë se kanë rënë dakord që shitësi kaparmarrës, z. I.H., këtë shtëpi banimi si më sipër, së bashku me të gjitha shtesat që ka bërë (2 ballkone), si dhe me të gjitha pajisjet e shtëpisë që janë sot në të (me përjashtim të dhomës së gjumit, pajisjeve që ndodhen në dhomën e ndenjes, si dhe frigoriferit, lavatriçes, televizorit e stufës me gaz dhe korrent), do t’ia shesë blerëses kapardhënëse, znj. H.V., në vlerën 4,500,000 lekë.

**33.16** Në vijim në këtë kontratë kapari përcaktohet se të dyja palët ranë dakord dhe kanë deklaruar se kontrata e shitblerjes ndërmjet tyre për këtë shtëpi, truallin e saj dhe pajisjet sipas përshkrimit do të bëhet brenda datës 30 maj të vitit 2000 – dhe se palët janë marrë vesh në përputhje me nenet 601 dhe 602 të Kodit Civil. *Në rast se kontrata e shitblerjes nuk bëhet me kushtet e përshkruara në kontratën e kaparit – dhe kur kjo nuk realizohet për fajin e blerëses kapardhënëse, znj. H.V., kjo e fundit e humbet këtë kapar.*

Neni 602 i Kodit Civil parashikon: -“...kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kapar, kjo palë humbet kaparin...”

**33.17** Në datën 17.7.2000 është lidhur kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie (pasurisë për të cilën ishte dhënë kapari nga ana e nënës së subjektit ), me vlerë totale 1,900,000 lekë, ku si palë blerëse shfaqet subjekti i rivlerësimit – dhe se kjo pasuri është regjistruar në emrin e tij. Pra, duket se shitësi ka pasur vullnetin e plotë për ta shitur këtë pasuri edhe pas mospërmbushjes së kontratës së kaparit.

**33.18** Referuar kësaj kontrate shitblerje, shitësi I.H., deklaron se pasurinë që ka në pronësi të tij (shtëpi banimi në pallatin \*\*\* me tre dhoma dhe një kuzhinë), ia shet blerësit Arben Vrioni, përkundrejt vlerës 1,900,000 lekë – të cilat deklaron se i ka marrë të gjitha në dorë nga blerësi Arben Vrioni, jashtë kësaj zyre noterie, të numëruara.

↓ **Për sa më sipër konstatohet** se për këtë pasuri janë kryer pagesat: (i) vlera 1,500,000 lekë nga nëna e subjektit në formën e kaparit (shumë e humbur pasi nuk është përmbushur kontrata); dhe (ii) vlera 1,900,000 lekë e paguar nga subjekti para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

**33.19** Në datën 5.3.2004, subjekti ia ka shitur këtë pasuri, z. M.R., kundrejt vlerës 1,900,000 lekë, për të cilën deklaron se e ka marrë të gjithën jashtë zyrës noteriale<sup>24</sup>.

<sup>24</sup> Referohuni, kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 5.3.2004.

**33.20** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ndër të tjera ka pretenduar se: *“Shitja e apartamentit z. M.R., ‘de facto’ ka ndodhur që në vitin 2002, por se kontrata u finalizua në datën 5.3.2004, pasi në këtë moment z. R., pagoi vlerën e mbetur të pa paguar prej 200,000 lekë. (ka paraqitur si dokumentacion provues, deklaratën noteriale nga shtetasi M.R.)”*.

**33.21** Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe vetdeklarimeve të subjektit konstatohet se kjo pasuri ka rrjedhur nga të ardhurat e nënës së tij dhe se të ardhurat e përfituara nga shitja e saj janë deklaruar si burim – për blerjen e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**33.22** Nga verifikimi i mandateve të dërguara nga subjekti për pagesat e kryera në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (të referuar edhe në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie) – rezulton se pagesa e plotë në favor të shoqërisë, në vlerën 6,000,000 lekë, është kryer deri në datën 10.7.2003. Si rrjedhim, konstatohet se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë shtetasit M.R., (në vlerën 1,900,000 lekë), nuk mund të kenë shërbyer për kryerjen e pagesave në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pra, nuk mund të merren në konsideratë si burim krijimi për pasurisë apartament, objekt hetimi – pasi referuar dokumentacionit ligjor shitja ka ndodhur në datën 5.3.2004.

**33.23** Komisioni, në vazhdim të veprimeve verifikuese lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së llojit apartament me sip. 157 m<sup>2</sup> (objekt hetimi), i kërkoi subjektit të konfirmojë nëse nëna e tij ka pasur/disponuar pasuri të tjera (përveç pasurisë së shitur Kishës \*\*\* në vitin 1996) të cilat i ka shitur ose dhënë me qira, dhe nëse po, cilat janë shumat e përfituara deri më 31.12.2003.

**33.24** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera keni deklaruar se: *[...] përveç pasurisë së shitur Kishës \*\*\* Shqiptare në vitin 1996, deri në vitin 2003 nëna e tij ka pasur në pronësi pasuritë: (1) bashkëpronare e një sipërfaqe trualli në Sarandë, por që nuk ka përfituar asnjë të ardhur deri në vitin 2003; dhe (2) ka pasur në bashkëpronësi me babanë dhe të vëllanë e subjektit apartamentin e shitur në vitin 2009 shtetasit E.M., apartament ku ajo ka banuar në vitet 1991-2000. Ky apartament në periudhën 2001 – 2008, i është dhënë me qira shoqatës “\*\*\*\*”, e cila ka qenë një shoqatë, që operonte në fushën e ndihmës sociale në qytetin e Elbasanit dhe që pas 2009, u largua si shoqatë. Përfitimet nga kjo qira kanë qenë rreth 1,000,000 leke dhe se, deri në vitin 2003 shuma e përfituar është rreth 336,000 lekë [...].* Subjekti ka shpjeguar se është përpjekur të disponojë dokument justifikues për të ardhurat e përfituara nga qiraja, por nuk ka mundur dot, pasi sipas tij i gjithë dokumentacioni ndodhet në shtetin italian.

**33.25** Për sa më sipër Komisioni konstaton se shuma e pretenduar, si e përfituar prej nënës së tij nga qiradhënia e kësaj banese, është e karakterit deklarativ. Për më tepër, siç e shpjegon edhe vetë subjekti – kjo pasuri ka qenë në bashkëpronësi të prindërve me të vëllain dhe si rrjedhim të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga qiradhënia, nuk mund të jenë vetëm të ardhura të përfituara nga nëna e tij – pra, nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**33.26** Me qëllim evidentimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesës në vlerën 6,000,000 lekë për blerjen e pasurisë së llojit apartament në vitin 2003, Komisioni mori në analizë të gjitha pasuritë e krijuara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij deri më 31.12.2003

(deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë), bazuar edhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti për burimin e krijimit të tyre – duke vlerësuar se deklaratat “Vetting” prevalon mbi të gjitha deklaratimet e bëra në deklaratat periodike vjetore, apo në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**33.27** Në deklaratën fillestare të pasurisë, përveç apartamentit të banimit me sip. 157 m<sup>2</sup>, në vlerë 6,000,000 lekë, subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë deklaruar edhe pasuritë: (1) automjet, tip “Mercedez Benz”, me targa EL \*\*\*, vit prodhimi 1984, në vlerë 300,000 lekë, blerë me kursimet nga paga; (2) llogari depozite në BIA, në vlerë 26,000 USD, me burim të ardhurat e dhuruara nga nëna e tij; dhe (3) vlerën 1,000,000 lekë, depozitë në “Tirana Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit, me burim krijimi të ardhura të dhuruara nga prindërit e saj si pjesë e trashëgimisë.

**33.28** Pra, rezulton se në datën 31.12.2003, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja e tij) dispononin këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme: (1) pasurinë e llojit apartament blerë në vitin 2000, me vlerë 1,900,000 lekë; (2) pasurinë e llojit apartament, porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 6,000,000 lekë; (3) depozitë në vlerën prej 26,000 USD; (4) automjet me vlerë 300,000 lekë; dhe (5) depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit në vlerën 1,000,000 lekë.

**33.29.** Si burim krijimi të këtyre pasurive subjekti ka deklaruar: (i) për dy pasuritë e llojit apartament dhe për depozitën në vlerën 26,000 USD, të ardhurat nga nëna nga shitja e pasurisë në Gjirokastrë – dhe referuar deklaratës fillestare të pasurisë dhe përgjigjeve të pyetësorit edhe vlerën 1,000,000 lekë nga kursimet e tij dhe të familjes; (ii) për pasurinë e llojit automjet, kursimet nga pagat; dhe (iii) për pasurinë e llojit depozitë, personi i lidhur në deklaratën fillestare e ka deklaruar si shumë e dhuruara nga prindërit e saj – ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaruar si pjesë e kursimeve nga pagat e saj dhe të bashkëshortit.

↓ **Për sa më sipër konstatohet** mospërputhje lidhur me burimin e krijimit të depozitës me vlerë 1,000,000 lekë gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit në fund të vitit 2003, – pasi personi i lidhur në deklaratën “Vetting”, si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e kursyera nga pagat e saj dhe të subjektit – ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë ka deklaruar si burim krijimi të ardhura të dhuruara nga prindërit e saj.

**33.30** I pyetur nga Komisioni me këtë fakt, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se: *[...] kjo depozitë e hapur në ‘Tirana Bank’, në vlerën 1,000,000 lekë, në dhjetor 2003, është dhuratë, që nëna e saj i ka dhënë bashkëshortes së tij. Deklarimi në deklaratën “Vetting” për burimin e kësaj shume është pasaktësi [...].*

Në lidhje me burimin e kësaj shume subjekti ka shpjeguar se: *[...] ky dhurim i është dhënë cash bashkëshortes së tij nga nëna e saj [...] – duke specifikuar se burimi i krijimit të vlerave cash të prindërve të bashkëshortes kanë ardhur nga:*

a) *[...] shitja e një dyqani në Korçë, pronë e babait të bashkëshortes, shitur rreth viteve 94-95, nuk e di me siguri, por nga shitja u përfituan rreth 800,000 lekë, pasuri e cila ishte në emër të babait dhe xhaxhait të bashkëshortes, por në rrethanat kur kanë kaluar 25 vjet dhe kur të dy pronarët e pasurisë kanë ndërruar jetë, -subjekti sqaron se nuk mund të gjejë prova për ti*

*paraqitur, pasi nuk di numrin e pasurisë së shitur dhe personat blerës, në mënyrë që ZRPPP-ja Korçë, të shohë transformimin e pronës [...].*

b) [...] *Shitja e një ndërtese dy katesh me truallin me sipë 225 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtese dy kate më sip. 131 m<sup>2</sup> me numër pasurie \*\*\* z.k. \*\*\*, me adresë pasurie: Lagja “\*\*\*”, shitur shtetasit B.G., [...].*

**33.31** Sipas vetëdeklarimeve të subjektit, kjo pasuri është dorëzuar dhe shitur faktikisht në muajin dhjetor 2003, në vlerën 4,800,000 leke, por kontrata e shitjes është formalizuar në datën 9.2.2004. Pjesa e përfituar nga kjo pasuri për znj. A.M., është 1/6 pjesë.

**33.32** Nga përmbajtja e kontratës së shitjes<sup>25</sup> del se kjo pasuri është shitur në vlerën 500,000 lekë, fakt për të cilin subjekti deklaroi se nuk është i vërtetë dhe ka depozituar si provë deklaratën noteriale të lëshuar nga blerësi i kësaj pasurie shtetasi B.G.

c) [...] *Letrat me vlerë të përfituara për kompensimin pasuror të ish të përndjekurve dhe të dënuarve politikë nga sistemi komunist [...]. Subjekti deklaroi se: [...] gjyshërit e bashkëshortes së tij kanë vuajtur dënime si të dënuar politikë dhe që të dy kanë vdekur gjatë vuajtjes së dënimit [...]*

d) [...] *Apartamenti i fituar nga vëllai i nënës së bashkëshortes, z. J.H., përfituar nëpërmjet Entit të Banesave Durrës, në kompensim pasuror të ish të përndjekurve politikë – dhe se ajo (nëna e bashkëshortes) ka përfituar pjesën takuese prej 1/6 të vlerës së pasqyruar në fletoren zyrtare Nr. 102, të vitit 2015, me nr. rendor \*\*\* [...].*

e) [...] *Qiratë e herëpashershme nga shtëpitë e babait të bashkëshortes në qytetin e Korçës, nga periudha kur u kthyen këto pasuri tek ish-pronarët [...].*

**33.33** Komisioni vlerëson se referuar pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka pasur detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Gjithashtu, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshmën të pasurive dhe të të ardhurave.

**33.34** Në pikën 1, të nenit 32, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”.

**33.35** Nga verifikimi i deklaratës “Vetting” dhe i dokumentacionit të dorëzuar në ILDKPKI konstatohet se subjekti ka deklaruar se depozita në vlerën 1,000,000 lekë është e krijuar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga pagat – duke dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me këto të ardhura.

**33.36** Subjekti pretendon se kjo depozitë është krijuar nga dhurimet e prindërve të bashkëshortes së tij – por subjekti nuk e ka deklaruar këtë fakt në deklaratën “Vetting” dhe nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor që të justifikojë këtë burim (me dorëzimin e deklaratës “Vetting”).

---

<sup>25</sup> Kontrata me nr. \*\*\*, datë 9.2.2004.

**33.37** Si rrjedhim, në analizën financiare vlera 1,000,000 lekë (gjendje si depozitë në “Tirana Bank” në fund të vitit 2003), do të merret si shumë e krijuar me burim, të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij.

**33.38** Për më tepër, referuar pretendimeve të subjektit për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, si burim krijimi i depozitës në vlerën 1,000,000 lekë, duket se: (1) nuk disponohet dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga babai bashkëshortes nga shitja e dyqanit në qytetin e Korçës; (2) vlera 500,000 lekë është e përfituar nga shitja e ndërtesës dy katesh dhe truallit në lagjen “\*\*\*”, Elbasan, dhe se kjo pasuri është shitur në datë 9.2.2004, pas krijimit të depozitës; (3) nuk disponohet dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e përfituara nga nëna e bashkëshortes nga shitjet e pasurive të paluajtshme, nga letrat me vlerë – dhe as për të ardhurat nga qiratë e babait të bashkëshortes; dhe (4) nuk disponohet dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga gjyshërit e bashkëshortes së tij.

**33.39** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, Komisioni, kreu analizën e tregueseve financiare lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur, për periudhën korrik 1994 – 31.12.2003 – sipas së cilës rezultoi se subjekti nuk pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera deri më 31.12.2003.

**33.40** Subjektit iu kalua barra e barra e provës<sup>26</sup> për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e Komisionit – për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera deri më 31.12.2003.

**33.41** Në prapësimet<sup>27</sup> e sjella në Komision, si dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore subjekti ka pretenduar se: (i) kapari i dhënë nga nëna e tij, znj. H.V., nuk është humbur – por i është kthyer mbrapsht nga shtetasi I. H., dhe ka paraqitur si dokumentacion provues deklaratën noteriale<sup>28</sup> të datës 9.11.2019 të shtetasit I. H.; (ii) brenda periudhës shtator 2002 – dhjetor 2003 është arkëtuar vlera prej 1,700,000 lekësh prej shtetasit M.R., nga shitja e apartamentit; (iii) përlllogaritje të ndryshme të këmbimit të shumës prej 31,143 USD – të përfituar nga shitja e pasurisë së nënës në Gjirokastrë, si dhe ka pretenduar se kjo shumë është futur në qarkullim civil nga babai i tij duke gjeneruar të ardhura; (iv) eliminimin/reduktimin e shpenzimeve të mobilimit deklaruar në pyetëtorin nr. 1; dhe (v) rivlerësim të ndryshimeve të gjendjeve të mjeteve monetare – duke kërkuar që të bëhet veçmas për monedhën lekë dhe veçmas për monedhën dollarë, pasi pretendon se është eliminuar influenca e kursit të këmbimit.

**33.42** Komisioni vlerësoi me objektivitet të gjitha pretendimet e subjektit lidhur me analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit që i përket periudhës korrik 1994 – 31.12.2003.

**33.43** Së pari – Komisioni, për sa i përket pretendimit se kapari i dhënë nga nëna e tij në vitin 1999 i është kthyer mbrapsht nga shtetasi I.H., çmon se ky pretendim ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në dokumentacion provues. Për më tepër, Komision ka dyshime se çmimi real i blerjes së pasurisë nga subjekti në vitin 2000 është në vlerën 4,500,000 lekë (ku

<sup>26</sup> Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>27</sup> Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 10.11.2019.

<sup>28</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.11.2019.

përfshihet dhe kapari i dhënë në vitin 1999) – sipas parashikimeve të bëra në kontratën noteriale të kaparit të nënshkruar mes nënës së tij dhe shtetasit I. H., – kjo në konsideratë të faktit se vullneti i shtetasit I.H., ka qenë i qartë për të realizuar shitjen e kësaj pasurie, dhe se kjo pasuri i është shitur me kontratë shitjeje djalit të kapardhënës. Gjithsesi, në analizë financiare do të pasqyrohet si shpenzim (pagesë e kryer) dhënia e kaparit në vlerën 1,500,00 lekë në vitin 1999 – i cili do konsiderohet si i humbur, si dhe çmimi i pasqyruar në kontratën e shitjes në vitin 2000, në vlerën prej 1,900,000 lekë.

**33.44** Së dyti – pretendimi i subjektit se vlera 1,700,000 lekë nga shitja e pasurisë M.R., arkëtuar në periudhë shtator – dhjetor 2003, nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova.

**33.45** Së treti – Komisioni, lidhur me të ardhurat e nënës nga shitja e pasurisë në Gjirokastrë që kanë shërbyer si burim krijimi të pasurive të subjektit të rivlerësimit, vëren se në kontratë e shitjes së kësaj pasurie përcaktohet se çmimi do të paguhet në tre këste: (i) *ditën e nënshkrimit të kontratës vlera 140,000 USD; (ii) kësti i dytë brenda datës 15.1.1997 në vlerën 119,000 USD; dhe (iii) kësti i tretë brenda datës 15.4.1997 në vlerën 141,000 USD. Çdo këst do të ndahet sipas pjesëve përkatëse – dhe znj. H.V., (nëna e subjektit) merr 3/21 pjesë të këstit.*

**33.46** Referuar përcaktimeve në kontratë, nëna e subjektit të rivlerësimit, duhet të përfitonte: (i) në datë 13.11.1996, vlerën 20,000 USD; (ii) brenda datës 15.1.1997, vlerën 17.000 USD; dhe (iii) brenda datës 15.4.1997, vlerën 20,143 USD

**33.47** Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *[...] pjesa e nënës është në vlerën 57,143 USD, kjo vlerë është marrë në 2 këste, njëri në vitin 1996 dhe pjesa tjetër në vitin 1997. Në qershor të vitit 1997, u paguan 240,000 USD, nga Kisha \*\*\* [...].*

**33.48** Gjithashtu, subjekti rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] vlera prej 31,143 USD është konvertuar në muajin qershor të vitit 1997, ndërsa vlera prej 26,000 USD është depozituar në dollarë dhe nuk ka pasur ndryshim për një kohë të gjatë siç shihet edhe në raportet e “BKT-së [...].*

**33.49** Nga hetimi administrativ i kryer konstatohet se mungon dokumentacion provues për kohën e përfitimit të shumave nga shitja e pasurisë në Gjirokastrë nga nëna e subjektit, si dhe nëse është këmbyer vlera prej 31,143 USD dhe momentit të këmbimit të saj.

**33.50** Komisioni, në mungesë të dokumentimit të kohës së transaksionit/konvertimit (ditën dhe muajin), vlerësoi që për konvertimin e vlerës 31,143 USD të merret kursi mesatar vjetor i këmbimit për vitin 1997, i publikuar nga Banka e Shqipërisë (1USD=148.93 lekë)<sup>29</sup>. Shuma e konvertuar në lekë do të pasqyrohet në analizën financiare për periudhën korrik 1994 – 31.12.2003, si e ardhur që ka shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit.

---

<sup>29</sup> Praktikë kjo e përdorur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në rastin e përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, ku konkretisht shprehet se: *-shpenzimet e llogaritura në valutë do të konvertohen në lekë sipas kursit mesatar vjetor të publikuar nga BSH, përveç rasteve kur kursi i këmbimit është përcaktuar shprehimisht në aktet shkresore justifikuese për transaksionin përkatës dhe kur data e transaksionit është e provuar me akt shkresor, rast në të cilin do të aplikohen kurset e datës së kryerjes së transaksionit sipas të njëjtit burim zyrtar...* (vendim, nr.11, datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit).



**33.51** Lidhur me pretendimin se kjo shumë është futur në qarkullimin civil nga babai i subjektit dhe si rrjedhim janë përfituar të ardhura të tjera – Komisioni çmoi se ky pretendim ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova, dhe si i tillë nuk merret në konsideratë.

**33.52** Së katërti – Komisioni, lidhur me pretendimin e subjektit për shpenzimet e mobilimit/arredimit të apartamentit të tij, vëren se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] në apartamentin tonë në lagjen “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, sh. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, jetojmë që prej 2 shtatorit e deri tani. Mobilimi i tij nuk ka ndryshuar që prej vitit 2002 dhe ka vlerën prej rreth 700,000 lekë [...].*

**33.53** Subjekti ka pretenduar se shpenzimet e mobilimit janë pjesë e shpenzimeve jetike dhe nuk duhet të pasqyrohen si shpenzime më vete.

**33.54** Për sa i përket vendit që zënë shpenzimet për mobilim/arredim në strukturën e shpenzimeve totale, referuar të dhënave të INSTAT, konkretisht strukturës së konsumit të familjeve shqiptare rezulton se – grupi i konsumit “*mobilitim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme banese*, zë afro 6% në strukturën e shpenzimeve totale.

**33.55** Shpenzimet e përllogaritura nga Komisioni, për periudhën objekt analize, janë në vlerën totale 2,458,768 lekë. Si rrjedhim, shpenzimet për mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme banese, referuar përqindjes në strukturën e konsumit të familjes, zënë afërsisht vlerën 147,526 lekë.

**33.56** Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se shpenzimet e mobilimit/arredimit do të pasqyrohen më vete në analizën financiare, në vlerën prej 552,474 lekë (700,000 lekë – 147,526 lekë).

**33.57** Gjithashtu, vlera prej 26,000 USD e vendosur në llogarinë e përbashkët bankare të subjektit të rivlerësimit me nënën e tij, për efekt të analizës financiare u pasqyrua në vlerën në lekë të konvertuar me të njëjtin kurs këmbimi si në zërin të ardhura nga dhurimi, po ashtu dhe në zërin e ndryshimit të gjendjeve monetare.

**33.58** Për më tepër, referuar të dhënave të dërguara nga “Tirana Bank” rezulton se nëna e subjektit, znj. H.V., në fund të vitit 2004 ka pasur gjendje në llogarinë depozitë vlerën 2,700,000 lekë, krijuar si vijon: (i) më 14.6.2004 ka depozituar vlerën 1,000,000 lekë; (ii) më 21.7.2004 ka depozituar vlerën 1,200,000 lekë; dhe (iii) më 19.8.2004 ka depozituar vlerën 500,000 lekë.

**33.59** Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë burimin e krijimit të vlerës 2,700,000 lekë, gjendje në datën 31.12.2004 në llogarinë bankare të nënës së tij në “Tirana Bank”, subjekti ndër të tjera ka deklaruar se: *[...] kjo pasuri është krijuar nga konvertimi i disa monedhave floriri të disponuara nga nëna e tij, si dhe nga futja në qarkullim civil dhe përfitimi nga interesat bankar të shumës prej 31,143 USD nga shitja e pasurisë së nënës në vitin 1996 [...].*

**33.60** Në dritën e këtyre fakteve të reja, duket i dyshimtë deklarimi i subjektit se burim krijimi i pasurisë së tij është e gjithë vlera e përfituar nga shitja e pasurisë së nënës në qytetin e Gjirokastrës – kjo në konsideratë të faktit se burimi i krijimit të pasurisë së llojit depozitë në emër të nënës së subjektit në vitin 2004 është i karakterit deklarativ, po ashtu edhe mundësisë së shpërndarjes së kësaj shume edhe te familjarët e tjerë.

**33.61** Gjithsesi, si përfundim nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe të provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën korrik 1994 – 31.12.2003, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

<b>Analiza financiare</b>	
<b>Periudha 1.7.1994-31.12.2003</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, periudha 1.7.1994 –31.12.2003	3,654,013
Të ardhura e bashkëshortes të vërtetuara, periudha 1.7.1994 –31.12.2003	852,617
Të ardhura nga nëna, kaluar në depozite bankare 26,000 USD, dhuruar	2,825,940
Të ardhura të tjera (dhuruar nga nëna me burim nga shitja e ndërtesës Gjirokastër 1996-1997) - shuma 31,143 USD.	4,638,127
Të ardhura të tjera (interesa bankar)	22,313
<b>Total të ardhura</b>	<b>11,993,010</b>
Shpenzime te tjera, mobilim, arredim deklaruar pyetësor nr. 1, integruar me shpenzimet sipas INSTAT	552,474
Pagesë shpenzime jetese familja periudha 1994 – 1999 deklaruar në pyetësorin nr. 3	900,000
Pagesë shpenzime jetese familja për periudhën 2000 – 2003 ILDKPKI, INSTAT	1,558,768
<b>Shpenzime total</b>	<b>3,011,242</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklaruar	0
Ndryshim mj .monetare banke gj. fillim - gj. fund periudhe dokumentuar	-3,848,253
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>5,133,515</b>
Pagesa për blerje autoveturë në vitin 2003 deklaruar	300,000
Pagesë për blerje ap. më sip. 157 m <sup>2</sup> periudha 2002–2003	6,000,000
Pagesë kapari nga nëna me kontrate ne vitin 1999	1,500,000
Pagesë për blerje pasuri të paluajtshme viti 2000	1,900,000
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>9,700,000</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-4,566,485</b>

▼ **Për sa më sipër, Komisioni konstaton** se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera deri më 31.12.2003.

**34. Pasuria e llojit autoveturë, tip “Mercedes Benz”, me targa AA \*\*\***, vit prodhimi 2010, me vlerë **12,000 USD**, blerë<sup>30</sup> në datën 10.10.2016. Subjekti deklaron se zotëron 100 % të kësaj pasurie.

**34.1** Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar, depozitën në dollarë në Bankën Kombëtare Tregtare, në emrin e tij dhe të nënës së tij, e krijuar në vitin 2000, pas tërheqjes dhe mbylljes së depozitës në vlerën prej 26,000 USD në BIA (krijuar më datë 9.6.1997 në Bankën Italo - Albanese).

<sup>30</sup> Kontrata me nr. \*\*\*, datë 10.10.2016.

## Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**34.2** DPSHTRRja<sup>31</sup>, konfirmon se në emrin e subjektit figuron i regjistruar automjeti me targa AA \*\*\* si dhe dërgon dosjen e plotë të këtij mjete (marka “Mercedes Benz”, tipi 204, modeli GLK 220 C). Nga verifikimi i dosjes së këtij mjete, vërehet se: (i) më 5.5.2016, ky automjet është blerë nga shtetasi A.D., në Gjermani, për vlerën 16,500 euro; (ii) më 9.5.2016 është kryer zhdoganimi i këtij mjete, vlera e detyrimit doganor të paguar në vlerën 460,000 lekë; (iii) pas zhdoganimit, vlera në total e këtij mjete vlerësohet të jetë rreth 2,750,000 lekë (pa llogaritur transportin nga vendi i origjinës dhe as detyrimet e paguara për regjistrimin dhe targimin e tij); (iv) më 11.5.2016, shtetasi A.D., ia shet këtë automjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën prej 900,000 lekë. Në kontratë citohet se: “... *motori i makinës nuk është në gjendje pune dhe se shitësi nuk merr përsipër pasojat që mund të rrjedhin nga ky defekt teknik në të ardhmen...*”; (v) më 10.5.2016, subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 20,000 USD, nga llogaria e tij në BKT – një ditë para shitjes së këtij mjete shoqërisë “\*\*\*\*”; (vi) më 12.5.2016, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka kryer kontrollin fizik të këtij mjete dhe e ka regjistruar në emrin e vet (nuk ka të dhëna për kolaudimin), megjithëse sipas kontratës së shitjes së një dite më parë mjete nuk ishte në gjendje pune; (vii) në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se e ka përdorur këtë mjet para blerjes së tij, për shkak se donte ta provonte; (viii) më 10.10.2016, subjekti e ka blerë këtë automjet nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për vlerën prej 12,000 USD; dhe (ix) më 13.10.2016, mjete është regjistruar në emrin e subjektit, është kryer kontrolli fizik i mjetit, si dhe është deklaruar nga ana e tij “*humbje vjedhje dëmtim targe*” dhe janë ndërruar targat nga AA \*\*\* në AA \*\*\*.

**34.3** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ndër të tjera ka deklaruar se: *[...] ka tërhequr shumën prej 20,000 USD në datën 10.5.2016, pasi iu paraqit një variant blerje. Por, në fund bleu makinën e mësipërme në datën 10.10.2016, për shumën prej 12,000 USD [...].*

**34.4** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se pagesa prej 12,000 USD është kryer nëpërmjet transaksionit bankar – në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**34.5** Nga analizimi i të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 20,000 USD, një ditë para shitjes së këtij mjete shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., tre ditë pas zhdoganimit të tij dhe vetëm pesë ditë pas blerjes së tij në Gjermani. Në këtë këndvështrim, në konsideratë të faktit se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e ka blerë këtë mjet dy ditë pas kryerjes së procedurave të zhdoganimit, duket qartë se ky mjet ka qenë i destinuar për t’u shitur menjëherë pas zhdoganimit – dhe dyshohet se porositi i tij ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Arben Vrioni.

**34.6** Në kontratën e blerjes së këtij automjeti nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., referohen defekte në motor – por ndërkohë një ditë më vonë kjo shoqëri ka kryer kontrollin fizik të këtij mjete dhe e ka regjistruar si pasuri në emrin e saj.

**34.7** Gjithashtu, referuar kontratës së shitblerjes konstatohet se z. Arben Vrioni e ka përfutur këtë pasuri me një çmim rreth dy herë më të ulët, vetëm rreth pesë muaj pasi ishte blerë në shtetin gjerman, si dhe pasi ishin kryer të gjitha procedurat e zhdoganimit.

<sup>31</sup> Shkresat me nr. \*\*\*, datë 30.1.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 6.2.2019.

↓ **Për sa më sipër, Komisioni** ngre dyshime të arsyeshme se tërësia e transaksioneve të kryera deri në blerjen përfundimtare të këtij automjeti nga subjekti duket se janë bërë me qëllim për të fshehur vlerën reale të blerjes së tij – si rrjedhojë, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se kontrata e nënshkruar nga subjekti për shitblerjen e kësaj pasurie është fiktive.

**34.8** Me dërgimin e prapësimeve, z. Arben Vrioni, nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar dyshimet e ngritura nga trupi gjykues.

**35. Pasuria e llojit depozitë bankare në BKT**, në vlerën **13,881 USD**. Subjekti deklaruar se zotëron 100 % të kësaj pasurie. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: në datën 9.6.1997 nga nëna e tij është hapur depozitë bankare në dollar në Bankën Italo - Albanese (BIA), në vlerën 26,000 USD. Kjo depozitë është mbyllur në fund të vitit 1999, dhe në janar të vitit 2000 kjo vlerë është futur si llogari e re në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në këtë llogari shtohet dhe emri subjektit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**35.1** Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë burimin konkret të kësaj pasurie. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera subjekti shpjegoi se: [...] në deklaratën “Vetting” duhet të kishte cilësuar burimin fillestar të pasurisë 26,000USD dhe jo ti referohej 2 depozitave, të krijuara më parë. Bëhet fjalë për të vetmen depozitë të cilësuar që në deklaram e parë dhe që lëvizjet e së cilës i ka shpjeguar dhe për të cilën, me dorëzimin e deklartës “Vetting”, ka vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë burimin e krijimit të saj [...].

**35.2** Referuar të dhënave të dërguara nga “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>32</sup> konstatohet se në datën 11.12.2002 është transferuar në llogarinë e subjektit (llogaria me nr. \*\*\* në USD) vlera prej 26,000 USD, me urdhëruese nënën e subjektit, znj. H.V.

**35.3** Në vitin 2005, shuma prej 26,000 USD, ka kaluar në BKT. Nga verifikimi i kësaj llogarie në BKT<sup>33</sup> konfirmohet se gjendja e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” është në vlerën 13.881 USD.

↓ **Për sa më sipër, nga hetimi i kryer lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:** (i) deklarimi subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT për gjendjen e kësaj depozite në momentin e deklarimit; (ii) nuk ka dyshime lidhur me burimin e krijimit të saj.

**36. Gjendje llogarie page në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 447,434 lekë, më datë 20.1.2017.**

**36.1** “Raiffeisen Bank”<sup>34</sup>, informon se subjekti rivlerësimi disponon llogarinë e pagës me nr. \*\*\*. Nga verifikimi i kësaj llogarie, konfirmohet se gjendja e saj në datën 20.1.2017 (datë e dorëzimit të deklaratës “Vetting”) është në vlerën prej 447,434 lekë.

↓ **Për sa më sipër, Komisioni, konstaton** se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

❖ **Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshortja subjektit, znj. M.V.**

<sup>32</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 7.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 11.2.2019.

<sup>33</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 5.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019.

<sup>34</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.01.2019, protokolluar në KPK me nr. \*\*\* prot., datë 30.01.2019.

**37. Obligacione në vlerën 2,700,000 lekë në BKT**, për llogari të nënës së saj, znj. A.M. Si burim krijimi të kësaj pasurie personi i lidhur ka deklaruar: se në numrin e llogarisë së saj në BKT, në të cilin depozitohet paga nga institucioni ku punon në datën 4.7.2012, i ka kaluar vlera 1,600,000 lekë për llogari të nënës së saj, znj. A.M., sipas prokurës nr. \*\*\*, datë 6.9.2011. Kjo e ardhur është krijuar nga shitja e apartamentit të vëllait të nënës, z. T.H., pas vdekjes së tij (pjesa takuese). Kjo depozitë është shtuar me 1,000,000 lekë në muajin nëntor të vitit 2015, si rezultat i mbylljes së llogarisë në “ProCredit Bank” dhe kalimit në BKT, e cila ka qenë pjesë e pasurisë së vëllait të nënës, z. T.H. *Depozita në vlerën 2,700,000 lekë përfshirë dhe interesat, ka kaluar në obligacion 7-vjeçar.*

**37.1** Në vijim sqarohet se në “ProCredit Bank” në datën 8.9.2011, në emrin bashkëshortes së subjektit, për llogari të nënës së saj, znj. A.M., kalon një shumë parash nga i ndjeri vëllai i nënës së saj, z. T.H., në pjesën takuese, prej 2,455,812 lekë, si dhe një shumë tjetër prej 2,047.75 euro. Me prokurën nr. \*\*\*, datë 6.9.2011, kjo depozitë është pakësuar deri në vlerën 1,000,000 lekë dhe mbyllet përfundimisht në nëntor të vitit 2015 dhe transferohet në BKT.

**37.2** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera subjekti ka deklaruar se: *[...] vlera e kësaj depozite është administruar dhe poseduar nga bashkëshortja e tij, sipas prokurës së posaçme me të drejtë përdorimi të vlerës së depozituar[...].*

**37.3** Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse bashkëshortja e tij e ka përfituar të gjithë pjesën takuese të pasurisë së përfituar me trashëgimi ligjore nga e ndjera, nëna e saj, znj. A.M.

**37.4** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: *[...] bashkëshortja e tij, administron dhe disponon në 100 % depozitën e nënës, në pjesën takuese ardhur nga vëllai i saj, i ndjeri T.H., sipas prokurës së depozituar në bankë. Kjo depozitë është përdorur për nënën për çdo nevojë të saj, si dhe nga bashkëshortja e tij. Me vdekjen e nënës së bashkëshortes, kjo depozitë ka mbetur e paprekur dhe në dhjetor 2015 kaloi për blerje të obligacioneve shtetërore për 7 vjet, me miratimin e motrave të saj. Në momentin e përfundimit të maturimit, kjo shumë në gjendjen e saj përfundimtare do të ndahet në mënyrë të barabartë me motrat [...].*

**37.5** Subjekti ka depozituar në Komision, si dokumentacion provues: (i) deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 30.4.2012; (ii) prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 6.9.2011; dhe (iii) kontratën e shitjes së shtëpisë së trashëgimtarëve të z. T.H.

▼ Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me këtë pasuri të llojit depozitë, Komisioni konstaton se: (i) deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT; (ii) nuk ka dyshime lidhur me burimin e krijimit të saj.

### **38. Obligacione në vlerën 6,200,000 lekë në “Tirana Bank”**

**38.1** Lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite personi i lidhur ka deklaruar se: (i) më 30 dhjetor 2003 ka depozituar vlerën 1,000,000 lekë, krijuar nga kursimet familjare; (ii) më 25 maj 2005 ka depozituar vlerën 1,000,000 lekë, krijuar nga kursimet familjare; (iii) më 31 dhjetor 2007 ka depozituar shumën prej 1,200,000 lekë, krijuar nga kursimet familjare; (iv) më 6 korrik 2009 ka depozituar shumën 1,000,000 lekë, kjo shumë ka ardhur nga shitja e automjetit

të subjektit me targa EL \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 15.7.2008; dhe (v) vlera 2,000,000 lekë është e ardhur e përfituara nga interesat bankar të përfituara nga depozita e krijuar me vlerat e sipërpërmendura në “Tirana Bank”.

**38.2** Në datën 5.10.2015 depozita me vlerë 6,200,000 lekë në “Tirana Bank” është përfshirë në ankandin e obligacioneve me afat 3-vjeçar, sipas kontratës me nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2015.

**38.3** Lidhur me këtë depozitë në formë obligacionesh konstatohen mospërputhje dhe pasaktësi në deklaram, që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me burimin e krijimit të saj pasi: (i) në deklaratën fillestare deklarohet vlera 1,000,000 lekë, me burim krijimi të ardhura të dhuruara nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; dhe (ii) subjekti në deklaratat periodike vjetore të ndryshme ka deklaruar shtesa gjendje *cash* që përfshijnë të ardhura edhe nga vitet paraardhëse të deklaramit dhe se këto shtesa *cash* (kursime) kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj depozite.

**38.4** Në vijim të këtij materiali, në analizën financiare, do të trajtohet mundësia financiare e kursimeve *cash*, si dhe shitja e automjetit në vitin 2008, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimit e kësaj depozite.

↓ Gjithsesi, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

**39. Personi i lidhur ka deklaruar se zotëron pjesë në përqindje në pasuri të rrjedhura si trashëgimtare ligjore e pasurisë së babait të saj, z. G.M., si vijon:** (i) 6.66 % të pasurisë së llojit shtëpi banimi me oborr me sipërfaqe totale 166 m<sup>2</sup>, ndodhur në qytetin e Korçës; (ii) 6.66 % të pasurisë së llojit shtëpi banimi me sipërfaqe totale 152 m<sup>2</sup>, ndodhur në qytetin e Korçës; (iii) 6.66 % të pasurisë së llojit shtëpi banimi me sipërfaqe totale 140 m<sup>2</sup>, ndodhur në qytetin e Korçës; dhe (iv) 6.66 % të pasurisë së llojit tmime me sipërfaqe 10 m<sup>2</sup> dhe thellësi 15 m<sup>2</sup> (gjithsej 150 m<sup>2</sup>), ndodhur në qytetin e Korçës.

**39.1** Me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, lidhur me këto pasuri subjekti ka depozituar shkresën e ZVRPP-së Korçë, sipas së cilës në emër të z. K.J. M., figurojnë të regjistruara pronat e paluajtshme në sistemin e vjetër hipotekor me numra \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*. Këto pasuri ndodhen të regjistruara në sektorin e hipotekës dhe nuk kanë kaluar në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden dy dokumente vërtetim pronësie për pasuritë e sipërpërmendura dhe dokumenti dëshmi trashëgimie, sipas të cilit z. G.M., babai i bashkëshortes së subjektit, është trashëgimtar i këtyre pasurive.

**39.2** ZVRPP-ja Korçë<sup>35</sup>, na informon se bashkëshortja subjektit figuron bashkëpronare me 2/30 pjesë tek pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\* – si dhe bashkëpronare me 4/60 pjesë tek pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k.. \*\*\*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Korçë konstatohet se bashkëshortja e subjektit i ka përfituara këto pasuri nëpërmjet trashëgimisë ligjore.

↓ Për sa më sipër Komisioni konstaton se nuk ka dyshime lidhur me këto pasuri.

❖ Pasuri të deklaruar veçmas nga vajza e subjektit, znj. I.V.

<sup>35</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2019.

**40. Depozitë në vlerën 22,823 USD në llogarinë e znj. I.V., në bankën \*\*\*, SHBA.** Si burim krimi ka deklaruar kursimet nga paga si e punësuar në shoqërinë \*\*\*, Chicago (peridha e punësimit prej datës 17.8.2015 – 31.12.2016).

**40.1** Nga verifikimi për këtë pasuri konstatohet se me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite, megjithëse subjekti ka deklaruar të ardhura nga punësimi në SHBA i vajzës së tij dokumentacioni i paraqitur për dokumentimin e tyre, nuk është në formën e kërkuar nga ligji.

**40.2** Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të depozitohë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara nga vajza e tij nga puna e kryer në SHBA – në formën e kërkuar nga ligji.

**40.3** Me prapësimet e dërguara subjekti depozitoi në Komision kopje të *e-mail*-eve të vajzës së tij drejtuar Zyrës së Burimeve Njerëzore të \*\*\*, Chicago, për të ardhurat – si dhe përgjigjet e tyre bashkë me dokumentacionin e vënë në dispozicion. Këto *e-mail*-e së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur tyre janë depozituar të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i licencuar.

**40.4** Në vlerësim të dokumentacionit të mësipërm, Komisioni krijoi bindjen se ato referojnë të ardhurat e realizuara nga vajza e subjektit nga puna e saj në shoqërinë \*\*\*, Chicago, të cilat mundësojnë krijimin e depozitës së deklaruar – kjo në konsideratë të faktit se kjo depozitë është vetëdeklaruar nga personi i lidhur.

❖ **Pasuri të deklaruara veçmas nga e vajza e subjektit, znj. A.V.**

**41. Pasuri e llojit autoveturë, tip “Mercedez Benz”, vit prodhimi 2003, me targa AA \*\*\*,** me vlerë 200,000 lekë. Si burim krijimi personi i lidhur ka deklaruar shumën e dhuruar nga gjyshja e saj, e ndjera A.M.

**41.1** DPSHTRR-ja<sup>36</sup>, konfirmon se në emrin e vajzës së subjektit figuron i regjistruar automjeti me targa AA \*\*\*, si dhe dërgon dosjen e plotë të këtij mjeti (marka “Mercedez Benz”, modeli A170CDI). Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konfirmohet se ky automjet është blerë<sup>37</sup> nga vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. A.V., në datën 11.3.2014, për vlerën 200,000 lekë.

**41.2** Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, znj. A. M., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të znj. A. M., – të cilat kanë krijuar shumën e dhënë në formë dhurimi në favor të vajzës së subjektit.

**41.3** Me prapësimet e dërguara subjekti ka shpjeguar se vlera e dhuruar prej 200,000 lekë ka si burim vlerat e përfituara nga nëna e bashkëshortes së tij prej çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të vëllait të saj z. T.H. Subjekti sqaron se këto shuma të përfituara nga nëna e bashkëshortes së tij janë depozituar në llogari bankare në “ProCredit Bank”, duke krijuar

<sup>36</sup> Shkresat me nr. \*\*\*, datë 30.1.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 6.2.2019.

<sup>37</sup> Kontrata me nr. \*\*\*, datë 11.3.2014.

depozitë në emër të bashkëshortes së tij dhe të nënës së saj – depozitë e cila është administruar nga bashkëshortja e tij. Siç e ka deklaruar edhe më parë kjo depozitë është pakësuar në vitet 2012 dhe 2013 në vlerat 700,000 lekë dhe 800,000 lekë – dhe se një pjesë e tyre, konkretisht, vlera prej 200,000 lekë, i është dhuruar vajzës së tij për blerjen e automjetit.

↓ Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se: (i) deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja; (ii) nuk ka dyshime lidhur me burimin e krijimit të saj.

#### ❖ Pasuri të krijuara pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”

**42.** Subjekti në deklaratën periodike të vitit 2017, deklaroi se **zotëron 12/576 pjesë të pasurive:** nr. \*\*\*– sip. 25662 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 66688 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 4450 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* – sip. 15665 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip.8819 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 24213 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 5838 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* – sip. 93930 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 7000 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 15744 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 69590 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 6888 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 44414 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 17605 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 122413 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 35666 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 11468 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 11758 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 11025 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* – sip. 14124 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*– sip. 21025 m<sup>2</sup>; \*\*\*– sip. 212 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* – sip. 14843 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*– sip. 9498 m<sup>2</sup>, të llojit frut dhe arë, z.k. \*\*\* dhe \*\*\* në \*\*\* dhe \*\*\* Fier. Lidhur me këto pasuri, subjekti ka deklaruar se janë përfituar me vendimin me nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**42.1** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni subjekti ka dërguar<sup>38</sup> kopje të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi bazën e të cilit ka fituar pjesën takuese të këtyre pasurive.

↓ Për sa më sipër nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar dhe të administruar në dosje, Komisioni konstaton se nuk ka dyshime lidhur me këto pasuri.

**43.** Gjithashtu, konstatohet se në vitin 2017<sup>39</sup> subjekti ka porositur pasurinë e llojit apartament, të ndodhur në Tiranë.

**43.1** Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga UKT-ja konstatohet se bashkëshortja subjektit<sup>40</sup> ka prenotuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasuritë e llojit apartament (më sip. 118.3 m<sup>2</sup>) dhe një post parkimi, apartament në vlerën 82,810 euro dhe post parkimi në vlerën 7,000 euro.

Në këtë kontratë përcaktohet se: (i) kësti i parë me vlerë 500 euro është paguar ditën e nënshkrimit; (ii) kësti i dytë me vlerë 33,000 euro, do të likuidohet nga porositësi deri në fund të muajit nëntor 2017; dhe (iii) diferenca e mbetur e pashlyer në vlerën 56,010 euro do të shlyhet deri në fund të muajit mars të vitit 2018.

**43.2** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017 subjekti ka deklaruar se vlerën prej 4,493,800 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 71 m<sup>2</sup> në Elbasan, pasi e ka konvertuar në euro e ka kaluar me transfertë bankare në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. *Konstatohet se*

<sup>38</sup> E-mail datë 27.10.2019.

<sup>39</sup> Vetëdeklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 1.

<sup>40</sup> Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 20.11.2017.



*subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017 prenotimin e këtyre pasurive (apartamentit dhe garazhit) dhe të drejtat reale mbi to.*

**43.3** Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit në BKT ( me nr. \*\*\*, në lekë), konfirmohet transferimi i vlerës 4,493,800 lekë në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 20.11.2017 – dhe kjo shumë ka rrjedhur nga shitja e pasurisë së llojit apartament në qytetin e Elbasanit, e cila ishte në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten (trajtuar në pikën 1 të këtij materiali).

**43.4** Referuar të dhënave të dërguara nga “Tirana Bank” konstatohet se në datën 2.3.2018 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit (nr. \*\*\*, në lekë), është transferuar në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., vlera 6,825,000 lekë, më përshkrimin “kalim sipas kontratës së porosisë”. Konfirmohet se vlera 6,825,000 lekë ka ardhur si rezultat i kthimit të investimit në obligacion 3-vjeçar në “Tirana Bank”– deklaruar në deklaratën “Vetting” nga bashkëshortja e subjektit në vlerën 6,200,000 lekë obligacione në “Tirana Bank”.

↓ **Për sa më sipër Komisioni konstaton** se nuk ka dyshime lidhur me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

#### **44. Hua në vlerën 25,000 GBP (rreth 42,000 USD) dhënë në vitin 2009 nga baxhanaku i subjektit, z. B.D.**

**44.1** Në deklaratën “Vetting” në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar se në vitin 2009 vajza e tij, znj. I.V., u pranua të kryejë studimet në \*\*\* of the Atlantic (\*\*\*), kundrejt vlerës 43,000 GBP. Një pjesë të kësaj shume në vlerën 25,000 GBP, të barabartë me 42,000 USD, ia ofroi baxhanaku i tij, z. B.D., i cili jeton në Amerikë prej vitit 1990. Kjo hua iu dha pa interes dhe pa afat shlyerje dhe se është marrë me transfertë bankare, në datën 6.8.2009, nëpërmjet “Alpha Bank”.

**44.2** Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se lidhur me këtë hua të marrë në vitin 2009, ka shlyer në vitin 2015 vlerën 15,000 USD, nga të cilat 10,000 USD janë shlyer nga të ardhurat e tij (të cilat i ka pasur në lekë – të tërhequra nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank” në muajt e fundit të vitit 2014) dhe vlera 5,000 USD nga vajza e tij, nga të ardhurat e krijuara nga puna e saj. Ndërsa në vitin 2016 ka shlyer vlerën 10,000 USD nga të cilat 5,000 USD janë shlyer nga subjekti dhe 5,000 USD nga vajza e tij.

**44.3** Lidhur me këtë marrëdhënie huaje subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues, deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 13.11.2014, sipas së cilës shtetasi B.D., deklaron se, *ka kaluar në transfertë bankare në favor të vajzës së tij shumën prej 25,000 GBP për qëllime shkollimi – dhe se kjo shumë është transferuar si hua pa interes dhe pa afat kthimi, nën garancinë e prindërve të saj.*

**44.4** Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentin, nxjerrje llogarie të “Alpha Bank”, për datat 2.8.2009 – 6.8.2009, ku vërtetohet se në datën 5.8.2009 në llogarinë e vajzës së tij ka kaluar shuma prej 24.979 GBP nga z. B.D. (NY).

**44.5** Nga verifikimi i kryer nga Komisioni i llogarisë së vajzës së subjektit në “Alpha Bank”, konfirmohet transferata e mësipërme.

**44.6** Për të provuar burimin e krijimit të kësaj shume nga huadhënësi, z. B.D., subjekti paraprakisht ka depozituar në Komisioni, fotokopje të një letre të datës 25 prill 2013 nga shoqëria e sigurimit “\*\*\*\*” në lidhje me një marrëveshje të strukturuar që përfshin z. B. D., dhe znj. E.D., – nga ku vërehet se kjo letër nuk është origjinale ose një kopje e legalizuar në formën e kërkuar nga ligji.

**44.7** Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. B. D., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. B. D., – të cilat kanë mundësuar krijimin e shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

**44.8** Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të depozitohë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara nga z. B.D., të cilat kanë shërbyer për dhënien e kësaj huaje – në formën e kërkuar nga ligji.

**44.9** Subjekti, me prapësimet e dërguara depozitoi në Komision dokumentacion të pajisur me vulë apostile nga shteti Amerikan, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se z. B.D., ka disponuar të ardhura të mjaftueshme të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht shumën e dhënë hua në favor të subjektit të rivlerësimit.

#### ❖ **Transferta e kryer nga nëna e subjektit në favor të shtetasit B.D.**

**44.10** Në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, referuar të dhënave të dërguara nga OTP Bank, rezulton se nëna e subjektit, znj. H.V., në datën **17.8.2009** ka hapur llogari në USD në këtë bankë duke depozituar *cash* vlerën **35,000 USD** – dhe se po në të njëjtën datë këtë shumë e transferon për llogari të shtetasit B.D. (përfituesi i shumës).

**44.11** Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me këtë fakt, i cili ndër të tjera deklaroi se: *[...] baxhanaku tij, z. B.D., dispononte një shumë parash në Shqipëri të cilën kishte dëshirë ta investonte për blerjen e një banese, pasi atë që dispononte më parë e kishte shitur. Meqenëse pas një kohe të gjatë, nuk pëlqeu asnjë nga variantet për blerje banese, pasi nuk ishin me parametrat e kërkuara nga ana e tij – shuma iu kthye nëpërmjet transfertës bankare, të bërë nga nëna e tij [...].*

**44.12** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe vetdeklarimeve të dhëna nga subjekti në kuadër të procesit të hetimit administrativ, konstatohet se: (i) në datën 5.8.2009 shtetasi B.D., (baxhanaku subjektit) ka transferuar në llogarinë bankare të vajzës së subjektit në “Alpha Bank”, shumën prej rreth 25,000 GBP – të deklaruar nga subjekti si hua e dhënë për shkollimin e vajzës; (ii) subjekti nuk ka dokumentuar mënyrën kalimit të kësaj shume nga z. B.D., në shtetin shqiptar; dhe se (iii) nuk ka dhënë shpjegime bindëse se pse kjo shumë i është lënë në posedim pikërisht nënës së tij.

**44.13** Në analizimi i të dhënave të mësipërme vërehet një situatë kontradiktore lidhur me mënyrën e veprimit dhe tërësisë së transaksioneve për transferimin e këtyre vlerave monetare ku në të dy marrëdhëniet shfaqet z. B.D., (dërgues/përfitues) – pasi nga njëra anë në datën 5.8.2009 z. B.D., ka transferuar shumën prej 25,000 GBP në llogarinë bankare të vajzës së

subjektit dhe – nga ana tjetër nëna e subjektit në datën 17.8.2009 transferon shumën prej 35,000 USD në favor të z. B.D., (pra, vetëm 12 ditë më pas).

**44.14** Gjithashtu, konstatohet se dokumentohet trasferta e kryer në favor të vajzës së subjektit nga z. B.D., – por nuk dokumentohen të ardhurat e dërguara nga shtetasi B.D., në vlerën 35,000 USD dhe as periudha e dërgimit të kësaj shume nga ky shtetas në shtetin shqiptar.

**44.15** Për sa më sipër, trupi gjykues ngre dyshime të arsyeshme se vlera prej 35,000 USD transferuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit në favor të z. B.D., përfaqëson vlerën monetare që subjekti ka transferuar në favor të tij me qëllim kthimin mbrapsht të shumës prej 25,000 GBP të transferuara nga z. B.D., 12 ditë më parë, në llogari të vajzës së subjektit -si rrjedhim, duket se subjekti ka deklaruar një marrëdhënie fiktive huaje, me qëllim mbulimin e të ardhurave të pajustificuara që kanë shërbyer për shkollimin e vajzës së tij.

**44.16** Për sa sipër, me dërgimin e rezultateve shtesë të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime shteruese lidhur me këtë transfertë, të shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor.

**44.17** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e dërguara por edhe gjatë seancës dëgjimore dha shpjegimet e tij lidhur me këtë transfertë të kryer nga nëna e tij, si dhe mënyrën e transferimit të kësaj shumë nga shtetasi B.D., në shtetin shqiptar. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e subjektit dhe deklarimet e tij gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se z. Arben Vrioni nuk arriti të japë shpjegime bindëse të bazuar në dokumentacion ligjor provues, për të rrëzuar dyshimet e ngritura.

#### ❖ **Analiza financiare/gjetje në deklaratat periodike vjetore**

**45.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, për vitet 2003 – 2016 – sipas së cilës rezultuan se vitet 2005, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative të fondeve.

**45.1** Subjektit iu kalua barra e barra e provës<sup>41</sup> për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e Komisionit – për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet 2005, 2007 dhe 2009.

**46. Analiza financiare për vitin 2005:** Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: (i) vlerën prej 1,000,000 lekë shtesë në llogarinë bankare të bashkëshortes së tij në “Tirana Bank”; dhe (ii) këmbimin e automatit – duke deklaruar shtesë pagese prej tij në vlerën 50,000 lekë.

**46.1** Referuar deklaratës fillestare të pasurisë, si dhe deklaratës periodike vjetore të vitit 2004 konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shuma të kursyera *cash* në banesë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në vitin 2004 ka kursyer vlerën 500,000 lekë, dhe se

---

<sup>41</sup> Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

kjo vlerë ka shërbyer për krijimin e shtesës së llogarisë depozitë në vlerën 1,000,000 lekë, të depozituar në “Tirana Bank”.

**46.2** Komisioni çmon se ky pretendim ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në dokumentacion provues – kjo në konsideratë të faktit se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendje likuiditetesh *cash*.

**46.3** Si përfundim, në vlerësim të dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur – analiza financiare për vitin 2005 paraqitet në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza financiare</b>	<b>Viti 2005</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat neto nga pagat për periudhën	970,487
Të ardhurat e bashkëshortes për periudhën	384,546
Dhurata në vlerë monetare sipas deklaramit	100,000
Të ardhura të tjera	27,070
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,482,103</b>
Shpenzime udhëtime, pushime	180,992
Pagesë shpenzime jetese, INSTAT, IDKPKI	438,228
<b>Shpenzime total</b>	<b>619,220</b>
Ndryshim vl. mon <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	0
Ndryshim vl. mon banke gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	-1,418,467
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-555,584</b>
Pagesa për blerje autoveture, shtesë nga këmbimi i tyre	50,000
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>50,000</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-605,584</b>

↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitin 2005.

#### **47. Analiza financiare për vitin 2007**

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2006 konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 deklaroi kursime të dy viteve në vlerën 1,200,000 lekë (të cilat janë deklaruar si burim i shtesës prej 1,200,000 lekë në llogarinë depozitë të bashkëshortes së subjektit në “Tirana Bank”, në vitin 2007).

**47.1** Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, i pyetur nga Komisioni, ka deklaruar se: [...] nuk është në gjendje të përcaktojë me saktësi gjendjen *cash* të disponuar në fund të vitit 2006, por ajo duhet të ketë qenë rreth 600.000 lekë [...]. Konstatohet se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar shtesë pasurie, vlerën prej 600,000 lekë, si kursime *cash*.

**47.2** Me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ndër të tjera, ka pretenduar: (i) llogaritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin 2007 si mesatarizim të shumës së pasqyruar për vitin 2006 dhe 2008; si dhe (ii) reduktim të shpenzimeve për udhëtimin/qëndrim të vajzës së tij në SHBA.

**47.3** Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet prapësimet e subjektit, çmoi të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit dhe konkretisht: (1) përllogaritjen e shpenzimeve për jetesë në vitin 2007, si mesatarizim të shumës së pasqyruar për vitet 2006 dhe 2008 (në vlerën 492,354 lekë); si dhe (2) rillogaritje të shpenzimeve të udhëtimit/qëndrimit të vajzës së tij SHBA, pasi referuar deklaratës të subjektit ka qëndruar te motra e bashkëshortes.

**47.4** Si përfundim, në vlerësim të dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur – analiza financiare për vitin 2007 paraqitet në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza financiare</b>	<b>Viti 2007</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat neto nga pagat për periudhën	958,483
Të ardhura e bashkëshortes për periudhën	433,504
Të ardhura të tjera	225,909
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,617,896</b>
Shpenzime udhëtime, pushime, deklaruar	100,000
Pagesë shpenzime jetese, INSTAT, IDKPKI, mesatarizim periudha 2006 – 2008	492,354
<b>Shpenzime total</b>	<b>592,354</b>
Ndryshim vl. mon <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklaruar	600,000
Ndryshim vl. mon bankë gj.f fillim - gj. fund periudhë dokumentuar	-1,420,116
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>205,426</b>
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>0</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>205,426</b>

#### **48. Analiza financiare për vitin 2009**

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë pasurie: (i) vlerën 1,000,000 lekë, në depozitën në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortes së tij, me burim krijimi shitjen e automjetit në vitin 2008; dhe (ii) vlerën 1,300,000 lekë, si kursime *cash* nga paga e tij dhe e bashkëshortes, të krijuar në periudhën 2008 – 2009.

**48.1** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi shitje në vlerën 1,000,000 lekë, në datë 4.12.2008, të automjetit tip “Mercedes Benz”, por në këtë deklaratë nuk deklaroi kursime në *cash* shtesa/pakësime, gjendje datë 31.12.2008.

**48.2** Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë: (1) faktin e shitjes e këtij automjeti në vitin 2008 me një çmim disa herë më të lartë se çmimi i blerjes (deklaruar prej tij në deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, si i përfituar nga shkëmbimi i automjetit me targa EL \*\*\*, blerë në vitin 2003, për vlerën 300,000 lekë, duke paguar shtesën prej 50.000 lekë), pas afro 3 vitesh përdorim; si dhe (2) nëse janë shlyer detyrimet tatimore për këto të ardhura shtesë të përfituara nga shitja e këtij automjeti.

**48.3** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera subjekti ka shpjeguar se: *[...] Automjeti i shitur prej tij ka qenë në gjendje shumë të mirë, pasi është përdorur shumë pak. Ky automjet kishte të vendosur dhe të përshtatur dhe një impiant gazi, (impiant gazi i cili në momentin e blerjes së mjetit nuk funksiononte dhe u riparua prej tij), gjë që u pëlqye nga blerësi meqenëse ai do ta përdorte për autoskollë. Në vijim ka shpjeguar se nuk ka shlyer asnjë detyrim tatimor në lidhje me të ardhurën e përfituar nga shitja e këtij mjeti [...]*

**48.4** Komisioni vëren se shuma e deklaruar si e përfituar nga shitja e kësaj pasurie është deklaruar si burim krijimi i pasurisë së llojit depozitë, në emër të bashkëshortes së subjektit në vitin 2009.

**48.5** Për sa i përket tatimit mbi të drejtën e kalimit të pronësisë së automjetit, në legjislacionin tatimor nuk ka parashikim as të të ardhurat personale të tatueshme, neni 8, dhe as tek të ardhurat personale të përjashtuara, neni 8/1, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, por në rast se do të ketë fitime nga shitja e pasurisë së luajtshme (automjet), atëherë individit përfitues i kësaj të ardhure (fitimi = vlera e shitjes – vlera e blerjes), i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat.

**48.6** Si përfundim, Komisioni vlerësoi të mos marrë në konsideratë në analizë financiare të ardhurat shtesë të krijuara nga shitja e këtij automjeti, konkretisht shumën e përfituar nga diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së këtij mjeti, për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore.

**48.7** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: *[...] vlera e automjetit të shitur në datën 4.12.2008, automjet i ky i cili i është dorëzuar blerësit G.C., në korrik 2008, është marrë cash prej tij në vitin 2009 dhe për të provuar këtë fakt ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale të bërë nga dy subjektet e veprimtari juridik [...].*

**48.9** Subjekti, në vijim, ka shpjeguar se: *[...] nuk ka deklaruar kursimet e vitit 2008, për të cilat nuk mund të përcaktojë saktë vlerën, por ka deklaruar për dy vite bashkë 2008 dhe 2009. kursimet në cash për vitin 2008 duhet të kenë qenë rreth 600,000 lekë [...].* Konstatohet se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendje të ardhurash në cash nga shitja e automjetit vitin 2008.

**48.10** Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 në rubrikën “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, subjekti ka deklaruar dhuratë për studimet e vajzës në vlerën 800,000 lekë – dhënë nga babai i subjektit, z. M.V.

**48.11** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, deklaroi se: *[...]shuma prej 800,000 lekë i është dhënë nga babai në vitin 2010 – shumë kjo e përfituar nga shitja e banesës në lagjen “\*\*\*\*” [...].*

**48.12** Për sa më sipër, konstatohet se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me periudhën e përfitimit të vlerës prej 800,000 lekë, të deklaruar si e dhuruar nga babai i subjektit.

**48.13** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: [...] *kjo shumë i është dhënë cash dhe burim janë të ardhurat e babait nga shitja e banesës, në vlerën prej 2.511.740 lekë në datën 29.6.2009 [...].*

**48.14** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: [...] *dhurata në vlerën 800,000 lekë, nga babai i subjektit, për shkollimin e vajzës është bërë në vitin 2009, vit në të cilin është shitur dhe shtëpia. Për sa i përket deklaratimit të bërë se kjo dhuratë është bërë në vitin 2010, ka qenë pasaktësi nga ana tije [...].*

**48.15** Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. M. V., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Komisioni, bazuar në parimin e proporcionalitetit, kërkoi verifikimin e ligjshmërinë së burimit të të ardhurave të z. M.V., – të cilat kanë krijuar shumën e dhënë në formë dhurimi në favor të vajzës së subjektit.

**48.16** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në datën 29.6.2009 prindërit dhe vëllai i tij kanë shitur pasurinë e llojit apartament banimi të ndodhur në qytetin e Elbasanit, për vlerën prej 2,511,740 lekë – dhe se këto të ardhura të përfituara nga shitja e kësaj pasurie kanë shërbyer si burim i dhurimit të vlerës prej 800,000 lekë nga babai i subjektit në favor të vajzës së tij. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 26.9.2009.

**48.17** Për sa më sipër, nga verifikimi dhe analizimi i deklaratimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, Komisioni vlerëson se babai i subjektit të rivlerësimit dispononte burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumën në vlerën prej 800,000 lekë të dhuruar në vitin 2009.

**48.18** Gjithashtu, në rubrikën “*detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë*”, subjekti ka deklaruar: (i) huan e marrë nga baxhanaku i tij, z. B.D., në vlerën 25,000 GBP; si dhe (ii) detyrim ndaj \*\*\*College \*\*\* në vlerën 43,000 GBP – shlyer deri në 31.12.2009, vlera prej 21,000 GBP.

**48.19** Referuar të dhënave nga “Alpha Bank”, në llogarinë burimore në GBP të vajzës së subjektit, znj. I.V., në datën 5.8.2009, ka hyrë me transfertë nga z. B.D., shuma prej 24,979 GBP. Në datën 7.8.2009 është futur në depozitë me afat vlera 17,000 GBP. Në datën 14.08.2009 është transferuar vlera prej 10,500 GBP për llogari të \*\*\*. Pra, referuar kësaj llogarie bankare, për vitin 2009 janë transferuar vlera 10,500 GBP.

**48.20** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: [...] *pagesat për shkollimin e vajzës janë kryer si vijon: (i) më 14.8.2009 është paguar vlera 10,500 lekë; (ii) më 31.12.2009 vlera 10,500 lekë; (iii) më 10.8.2010 është paguar vlera 11,000 lekë; dhe (iv) më 5.1.2011 është paguar vlera 11,000 lekë. Të gjitha veprimet e pagesave janë bërë nëpërmjet veprimeve të kryera me Alpha Bank [...]. Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, i marrë nga “Alpha Bank”, tregon që vlera prej 10,500 GBP është transferuar në datën 31.12.2009 nga shtetasja E. T.*

**48.21** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: [...] në fund të muajit dhjetor 2009 duhej të dërgonte pagesën e dytë për vitin shkollor 2009-2010 në drejtim të \*\*\*. Meqenëse Invoice \*\*\* ishte i datës 7.12.2009, pagesa duhej bërë patjetër shumë shpejt. Në kushtet kur ishte dita e fundit e vitit 2009, vlerën 10,500 GBP, ia dha në dorë përgjegjëses së degës së Alpha Bank, e cila nëpërmjet arkëtares së kësaj dege, zj. E.T., kryen transfertën për llogari të vajzës së tij në drejtim të \*\*\*. Nga z. E.T., është hapur llogaria në datë 31.12.2009 dhe mbyllur në datë 05.01.2010. Pra, deklaroi ai, shtetasen E.T., nuk e njeh dhe as ka lidhje me të. Vlera prej 10,500 GBP e transferuar për llogari të vajzës së tij nuk është e saj, por është vlerë e krijuar nga kursimet e familjes së tij në vitet 2008 -2009 dhe pjesë nga dhurata në vlerën 800,000 lekë e dhënë nga babai tij, z. M.V. [...].

**48.22** Në prapësimet<sup>42</sup> e dërguara në Komision lidhur me analizën financiare të vitit 2009 subjekti ka pretenduar se: (i) vlera e shitjes së autoveturës në vitin 2008 është marrë prej tij në vitin 2009, gjithashtu, pretendon edhe llogaritje të plotë të vlerës së përfutur, duke i zbritur vetëm tatimin e papaguar për të ardhurat shtesë; (ii) shuma e deklaruar si gjendje kursimesh cash në vitin 2009 (deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009), ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të këtij viti; si dhe (iii) përlllogaritje të ndryshme nga këmbimi i vlerave monetare.

**48.23** Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet pretendimet e subjektit të rivlerësimit, çmoi të mos i marrë në konsideratë, pasi ato kanë kryesisht karakter deklarativ dhe nuk janë të bazuara në dokumentacion provues

**48.24** Për sa më sipër, bazuar në analizimin më sipër të dokumentacionit të administruar në dosje si vetëdeklarimeve të subjektit, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e tuaja dhe të personave të lidhur, për vitin 2009, pasqyruar në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza financiare</b>	<b>Viti 2009</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat neto nga pagat për periudhën	1,102,406
Të ardhurat e bashkëshortes për periudhën	531,494
Dhurata në vl. monetare sipas deklaramit, nga babai	800,000
Huara në vl. monetare	3,866,000
Të ardhura të tjera (interesa)	297,486
<b>Total të ardhura</b>	<b>6,597,386</b>
Shpenzime shkollimi	3,247,440
Pagesë shpenzime jetese, INSTAT, IDKPKI,	500,940
<b>Shpenzime total</b>	<b>3,748,380</b>
Ndryshim vl. mon cash gj. fillim - gj. fund periudhe, deklaruar	-700,000
Ndryshim vl. mon banke gj. fillim - gj. fund periudhe, dokumentuar	-4,216,687
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-2,067,681</b>

<sup>42</sup> Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 10.11.2019.



↓ Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara/të shtuara (likuiditetet) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2009.

#### **49. Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**49.1** Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve; (ii) ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të blerjes së automjetit në pronësi të tij, duke kryer në mënyrë indirekte fshehje të pasurisë; dhe (iii) ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti ka deklaruar një marrëdhënie fiktive huaje, me qëllim mbulimin e të ardhurave të pajustificuara që kanë shërbyer për shkollimin e vajzës së tij.

**49.2** Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara; dhe (2) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

### **V. KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupa gjykuese i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se ***subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.***

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, si dhe pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Vrioni, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 22.11.2019

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**

**Kryesuese**

**Alma FASKAJ**

**Anëtare**

**Pamela QIRKO**

**Relatore**

*Gledis HAJDINI*  
*Sekretare gjyqësore*